



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra IX

Prill

2003

Akte të papublikuara

Mars – Korrik 1998

	Faqe
Vendim i KM nr.214, datë 28.3.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 “Për shpërblimin e punës së punonjësve”..... 3
Vendim i KM nr.216, datë 4.4.1998	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995 “Për kriteret e vlerësimit të ndihmës ekonomike”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.689, datë 14.10.1996 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.208, nr.605 dhe nr.304”..... 4
Vendim i KM nr.218, datë 4.4.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.518, datë 12.8.1996 “Për kategorizimin, klasifikimin dhe regjistrimin e njësive akomoduese”..... 4
Vendim i KM nr.230, datë 4.4.1998	Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqëritë me kapital të përbashkët..... 5

Vendim i KM nr.232, datë 10.4.1998	Për rritjen e shpërblimit të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.....	8
Vendim i KM nr.233, datë 10.4.1998	Për zbatimin e ligjit “Për statusin e jetimit”.....	9
Vendim i KM nr.239, datë 10.4.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.598, datë 30.12.1997 “Për admininstrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në bazë të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës””.....	10
Vendim i KM nr.240, datë 10.4.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.910, datë 30.12.1996 “Për krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit”.....	11
Vendim i KM nr.244, datë 20.3.1998	Për Këshillin e politikës shkencore dhe të zhvillimit teknologjik.....	11
Vendim i KM nr.246, datë 10.4.1998	Për krijimin e Drejtorisë së Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave.....	12
Vendim i KM nr.247, datë 4.4.1998	Për negociimin e ndryshimit të ndërmjetësve financiarë në marrëveshjet ekzistuese të kredive dhe ndihmave të huaja	13
Vendim i KM nr.250, datë 30.4.1998	Për dhënie asistence ligjore kompanisë “Deloitte & Touche” gjatë procesit të likuidimit të shoqërive huamarrëse.....	14
Vendim i KM nr.267, datë 9.5.1998	Për ndarjen nga bashkësia ekonomike “Albbakër” dhe daljen njësi më vete të uzinës së kabllave në Shkodër dhe uzinës elektromekanike në Shkodër.....	15
Vendim i KM nr.271, datë 9.5.1998	Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore..	16
Vendim i KM nr.279, datë 9.5.1998	Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore....	22
Vendim i KM nr.280, datë 9.5.1998	Shpalljen si objekt i rëndësisë së veçantë shtetërore të Aeroportit të Rinasit.....	23
Vendim i KM nr.283, datë 9.5.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.356, datë 10.9.1997 “Për emërimin e guvernatorëve dhe zëvendësguvernatorëve të Republikës së Shqipërisë pranë institucioneve ndërkombëtare financiare e të zhvillimit”.....	24
Vendim i KM nr.298, datë 19.5.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 26.3.1998 “Për nënshkrimin e Kartës Europiane të Autonomisë Lokale”.....	24
Vendim i KM nr.300, datë 19.5.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 24.12.1997 “Për shfaqjen e interesit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për projektet e asistencës teknike të financuara nga Qeveria e Republikës së Italisë”.....	25
Vendim i KM nr.307, datë 19.5.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.182, datë 25.4.1995 “Për çmimet e shitjes së barnave”, ndryshuar me vendimin nr.21, datë 31.1. 1997.....	26

Vendim i KM nr.320, datë 23.5.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.549, datë 7.11.1994 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”.....	26
Vendim i KM nr.328, datë 2.6.1998	Për përbërjen dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve.....	27
Vendim i KM nr.332, datë 2.6.1998	Për miratimin e uniformës dhe të stemës së policisë.....	28
Vendim i KM nr.333, datë 2.6.1998	Për miratimin e normës së veshmbathjes për policinë.....	29
Vendim i KM nr.335, datë 2.6.1998	Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit.....	30
Vendim i KM nr.338, datë 23.5.1998	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.428, datë 20.10.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.429, datë 30.8.1993 “Për krijimin e komitetit qeveritar të bisedimeve të borxhit të jashtëm””.....	31
Vendim i KM nr.340, datë 23.5.1998	Për kompetencat e Bordit Kombëtar të ushqimeve.....	32
Vendim i KM nr.343, datë 5.6.1998	Për kalimin në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë të shërbimit të ekspertimit mjekoligjor.....	33
Vendim i KM nr.347, datë 23.5.1998	Për shkëputjen nga puna të subjekteve sportive për përgatitjen dhe pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë sportive ndërkombëtare	34
Vendim i KM nr.350, datë 23.5.1998	Për hapjen dhe mbylljen e disa përfaqësive diplomatike dhe konsullore.....	35
Vendim i KM nr.380, datë 30.4.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shtetit nga kundërvajtjet administrative”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.405, datë 15.8.1998.....	36
Vendim i KM nr.395, datë 24.6.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 10.4.1998 “Për miratimin e pesë marrëveshjeve hidrokarbure të raundit të dytë të kërkimit të naftës dhe gazit në tokë”.....	36
Vendim i KM nr.397, datë 24.6.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.239, datë 10.4.1998 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.598, datë 30.12.1997 “Për administrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në bazë të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës””.....	37
Vendim i KM nr.398, datë 24.6.1998	Për kontrollin financiar të personave juridikë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë nëpërmjet kompanisë “Coopers & Lybrand”.....	38

Vendim i KM nr.404, datë 1.7.1998	Për dhënien e lejes për funksionimin e institucioneve arsimore private.....	39
Vendim i KM nr.405, datë 24.6.1998	Për lehtësimin e papunësisë nëpërmjet zbatimit të programit të punëve publike.....	39
Vendim i KM nr.409, datë 1.7.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.137, datë 31.3.1994 “Për disa ndryshime në çmimet e artikujve energjetikë”.....	42
Vendim i KM nr.410, datë 1.7.1998	Për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.710, datë 18.12.1995 “Për zbatimin e çmimeve të ulëta të energjisë elektrike, gazoilit, qymyrgurit dhe ujit, për prodhimin e bukës”.....	42
Vendim i KM nr.411, datë 1.7.1998	Për krijimin e qendrës së formimit profesional të personelit të burgjeve.....	43
Vendim i KM nr.416, datë 9.7.1998	Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga privatizimi i shoqërive tregtare që veprojnë në sektorë jostrategjikë.....	43
Vendim i KM nr.417, datë 9.7.1998	Për administrimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në shoqëritë anonime, me kapital themeltar tërësisht shtetëror.....	44
Vendim i KM nr.418, datë 9.7.1998	Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative.....	45
Vendim i KM nr.426, datë 9.7.1998	Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit.....	46
Vendim i KM nr.430, datë 9.7.1998	Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive a institucioneve shtetërore.....	48
Vendim i KM nr.440, datë 16.7.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.591, datë 24.12.1997 “Për zgjidhjen e problemeve të mbetura në flotën detare tregtare, në Durrës”.....	50
Vendim i KM nr.442, datë 16.7.1998	Për krijimin e sh.a.-së “Agjencia për zhvillimin ekonomik”.	51

V E N D I M
Nr.214, datë 28.3.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 345
DATË 10.8.1992 “PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 “Për shpërblimin e punës së punonjësve” të bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 2, paga bazë minimale mujore bëhet 5800 lekë.

b. Për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore e pjesërisht jobuxhetore, paga mesatare e realizuar në muajin mars 1998, duke filluar nga data 1 prill 1998, rritet deri 20 për qind, sipas mundësive financiare të tyre. Në këtë rritje përfshihen edhe kompensimet.

c. Në pikën 7, në rreshtin e parafundit, raporti i pagave të jetë jo më i madh se 1:6.

d. Në pikën 8, paragrafi i parë ndryshohet si vijon: “Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë i sugjerohet të barazohet për efekt page me Ministrin e Financave. Drejtorët e bankave të nivelit të dytë, Drejtori i INSIG-ut, Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore barazohen për efekt page me Zëvendësministrin”.

e. Pika 8/1 ndryshohet si vijon: “Për shoqëritë aksionere me kapital tërësisht shtetëror pagat e drejtorëve caktohen nga organi, që ka në kompetencë emërimin e tyre. Raporti i pagës së drejtorëve, në krahasim me pagën më të ulët të punonjësve të këtyre shoqërive të jetë: Për shoqëritë aksionere deri me 200 punonjës, jo më i madh se 1:6, dhe për ato me mbi 200 punonjës jo më i madh se 1:7. Për Albakrin, Albkromin, Albpetrolin, Gjeoalbën, KESH-in, Telekomin dhe AMC-në jo më i madh se 1.9”.

f. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 4.5.1993 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 “Për shpërblimin e punës së punonjësve””, pika 2 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 prill 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.216, datë 4.4.1998

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.605, DATË 30.10.1995 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”
NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.689, DATË 14.10.1996 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.208, NR.605 DHE NR.304”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995, pika 1 shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“Është jashtë shtetit për çdo arsye për një periudhë mbi 6 muaj, me përjashtim të rasteve të studimit ose kurimit mjekësor”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.689, datë 14.10.1996, në pikën 2 shkronja “b” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur deri në momentin e lëvizjes së vendbanimit është trajtuar me ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm dhe vazhdon të plotësojë kushtet për përfitim të ndihmës ekonomike në vendbanimin e ri sipas legjislacionit në fuqi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.218, datë 4.4.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.518, DATË 12.8.1996 “PËR KATEGORIZIMIN, KLASIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E NJËSIVE AKOMODUESE”

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.518, datë 12.8.1996, pika 5 ndryshon si vijon:

“Të krijohet regjistri i njësive akomoduese në Ministrinë e Tregtisë dhe Turizmit. Çdo njësi akomoduese është e detyruar t’i nënshtrohet regjistrimit si në rastin kur përfshihet në guidën e klasifikimit të njësive akomoduese, ashtu edhe kur e ushtron këtë veprimtari akomoduese jashtë këtij kategorizimi e klasifikimi.

Regjistrimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari akomoduese në regjistrin e njësive akomoduese, do të bëhet pasi të paraqitet prej tyre vendimi i gjykatës për regjistrimin e tyre si person juridik me objekt ushtrimin e veprimtarisë akomoduese.

Subjektet juridike që ushtrojnë veprimtari akomoduese, për të bërë regjistrimin në zyrat e tatimeve, duhet të paraqesin, përveç dokumenteve të tjera, edhe certifikatën e regjistrimit dhe klasifikimit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Turizmit”.

2. Në të gjitha pikat e vendimit fjalët “Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit” dhe “Sekretari i Shtetit për Turizmin” ndryshohen dhe zëvendësohen përkatësisht me fjalët “Ministria e Tregtisë dhe Turizmit” dhe “Ministri i Tregtisë dhe Turizmit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.230, datë 4.4.1998

**PËR PRIVATIZIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË ZOTËRUARA
NGA SHTETI NË SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT**

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Privatizimi i pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqëritë me kapital të përbashkët bëhet duke u mbështetur në dispozitat e Kodit Civil dhe në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, si përfaqësuese e pronarit për pjesët e kapitalit të zotëruara nga shteti, miraton kalimin e privatizimit të këtyre pjesëve të kapitalit.

Ministria, institucioni qendror ose organi i pushtetit lokal, nga i cili ka pasur vartësinë ndërmarrja shtetërore në momentin e nënshkrimit të kontratës për krijimin e shoqërive me kapital të përbashkët, i kërkon ortakut joshetëror mendimin për transferimin e këtyre pjesëve të kapitalit që ortaku shtetëror ofron për privatizimin.

Miratimi i kërkesës do të konsiderohet i dhënë me akt të njohur të shoqërisë me kapital të përbashkët, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe aktet e themelimit të shoqërisë.

3. Pas miratimit të kërkesës për privatizim, organi përkatës shtetëror, i përcaktuar në paragrafin e dytë të pikës 2 të këtij vendimi, zgjedh një ose disa ekspertë nga lista e ekspertëve të miratuar për përgatitjen e dokumentacionit, për shitjen e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti.

4. Momenti i caktimit të ekspertëve konsiderohet fillimi i procesit të privatizimit të pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti.

Organi shtetëror, sipas përcaktimit në paragrafin e dytë të pikës 2, fton shoqërinë të caktojë një ekspert tjetër për vlerësimin e pjesëve të kapitalit që do të shiten.

Miratimi i ekspertëve miratohet me akt të njohur të shoqërisë.

Kur ortakët nuk merren vesh ndërmjet tyre, eksperti caktohet nga gjykata me procedurë të ngutshme dhe vendim të formës së prerë.

5. Ekspertët, së bashku me organin shtetëror, sipas përcaktimit në paragrafin e dytë të pikës 2, do të plotësojnë dosjen e privatizimit të kapitalit shtetëror të shoqërisë, e cila duhet të ketë domosdoshmërisht këto dokumente:

a) miratimin nga shoqëria të kërkesës për transferimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti;

b) bilancin e plotë ekonomiko-financiar të shoqërisë nga data e themelimit deri në datën e emërimit të grupit të ekspertëve;

c) relacionin e vlerësimit të pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti, që do të privatizohen;

d) aktet e themelimit të shoqërisë dhe ndryshimet e bëra në to;

e) dokumentacionin përkatës për truallin, ku e zhvillon veprimtarinë shoqëria dhe të dhëna për pozicionin gjeografik të saj.

6. Përgatitja e dokumentacionit dhe dërgimi i tij në organin shtetëror, që ka filluar procesin e privatizimit, bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e emërimit të ekspertëve.

Dokumentacioni i privatizimit, pas dorëzimit në organin shtetëror që ka filluar procesin e privatizimit, brenda 7 ditëve kalendarike duhet të përcillet në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, e cila e përcjell në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

7. Vlera e shitjes së kapitalit shtetëror llogaritet në raport me përqindjen përkatëse të kapitaleve të veta të shoqërisë.

Vlera minimale e pjesëve të kapitalit të shoqërisë, të zotëruara nga shteti, nuk do të pranohet të jetë më e vogël se vlera e tyre në momentin e fillimit të procedurës së privatizimit.

Pavarësisht nga zgjatja e procedurës së mëtejshme të privatizimit, vlera minimale e kuotës shtetërore që do të shitet, llogaritet nga data e themelimit të shoqërisë deri në momentin e caktimit të ekspertëve.

8. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, deri në 15 ditë nga marrja në dorëzim e dokumentacionit, bën publikimin për shitje të kuotës shtetërore.

Publikimi për shitjen e kuotave të kapitalit shtetëror në organet e shtypit bëhet jo më pak se tri herë në tri gazeta të ndryshme me qarkullim kombëtar.

9. Publikimi përmban:

- pjesët e kapitalit të zotëruara nga shteti si përqindje ndaj kapitalit të shoqërisë;

- vlerën minimale të pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti që do të vihen në shitje (në lekë);

- llojin e veprimtarisë dhe vendndodhjes;

- datën, orën dhe vendin e zhvillimit të ankandit.

10. Kërkesa me shkrim për blerje përmban:

- emrin dhe adresën e saktë të subjektit fizik ose juridik, që dëshiron të blejë pjesët e kapitalit të zotëruara nga shteti;

- dokumentin bankar që vërteton pagesën paraprake të 20% të vlerës së publikuar për blerje në lekë;

- mandatarkëtimi ose garanci bankare apo aktmarrëveshje për ngrirjen e shumës prej 20% për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

11. Komisioni i ankandit përbëhet nga:

Kryetar - përfaqësuesi i AKP-së;

Anëtar - juristi i AKP-së;

Anëtar - përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

Anëtar - përfaqësuesi i organit shtetëror, sipas përcaktimit në paragrafin e dytë të pikës

2;

Sekretar - punonjësi i AKP-së, pa të drejtë vote.

12. Pjesëmarrja në komision në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e ankandit

është e detyrueshme për gjithë anëtarët.

13. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- të sigurojë që para nisjes së ankandit, nëse të gjithë pjesëmarrësit në ankand janë të regjistruar dhe të identifikuar sipas dokumenteve që kërkon ligji;
- të paraqesë anëtarët e komisionit të pjesëmarrësit;
- të deklarojë vleftën fillestare të ankandit, që është vlere e publikuar e kuotës;
- të drejtojë marrjen e ofertave;
- të hartojë dokumentacionin për ecurinë e ankandit, që përbëhet nga procesverbali dhe raporti për përfundimin e ankandit. Ky dokumentacion nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të ankandit dhe pjesëmarrësit në ankand.

14. Vlere më e lartë e dhënë në ankand për blerjen e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti, i ofrohet fillimisht ortakut ose ortakëve joshitetorë, të përcaktuar në aktet e themelimit të shoqërisë.

15. Nëse ortakut (ose ortakët), të cilit i është bërë oferta me vleftën më të lartë të ankandit, brenda një afati prej jo më shumë se 10 ditësh nga dita e njoftimit, shpreh gatishmërinë për blerjen e pjesëve të kapitalit me këtë vleftë, duke e vërtetuar këtë me pagesën brenda afatit të lartpërmendur të vlerës prej 30% të vleftës më të lartë të ankandit, lëshohet autorizimi përkatës dhe njoftohet menjëherë personi që ka ofruar këtë çmim për tërheqjen e shumës së depozituar.

16. Në rast se miratimi nuk është dhënë brenda afatit të mësipërm, oferta quhet e refuzuar dhe pjesët e kapitalit të zotëruara nga shteti i ofrohen personit, që ka dhënë vleftën më të lartë të ankandit.

17. Në autorizimin që lëshohet përcaktohet pagesa e plotë në lekë. Kjo pagesë do të bëhet brenda një afati prej 30 ditësh nga data e lëshimit të autorizimit. Në rast se pagesa e plotë nuk kryhet, atëherë mbahet 20% e pagesës paraprake dhe procedurat fillojnë nga pika 9 e këtij vendimi.

18. Kur nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës në ankand, ortakut joshitetor i ofrohen pjesët e kapitalit me çmimin e publikuar.

19. Nga të ardhurat e shitjes së pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti 5% mbahen nga AKP-ja.

20. Të gjitha mosmarrëveshjet gjyqësore ndërmjet ortakëve në shoqëri ndiqen nga ministria, institucioni qendror ose organi i pushtetit lokal, nga i cili ka pasur vartësinë ndërmarrja shtetërore në momentin e nënshkrimit të kontratës për krijimin e shoqërive me kapital të përbashkët.

21. Për ish-pronarin e truallit, të cilit i është njohur prona nga komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave, dhe ky truall është futur në kapitalin e zotëruar nga shteti në shoqëritë me kapital të përbashkët, kompensimi do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

22. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.909, datë 18.11.1996, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.232, datë 10.4.1998

**PËR RRITJEN E SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS KUNDËR
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të paragrafit të katërt të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesit nazifashistë të popullit shqiptar” dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 26.4.1996, për shkak të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit në masën 73.78 përqind për periudhën janar 1995 deri në dhjetor 1997, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, ndryshuar me vendimin nr.2, datë 10.1.1996, shpërblimi i veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, rritet në masën 74 përqind si më poshtë:

- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja “a” nga 1500 lekë në muaj, bëhet 2610 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja “b” nga 1200 lekë në muaj, bëhet 2088 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja “c” nga 1000 lekë në muaj, bëhet 1740 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja “e” nga 300 lekë në muaj, bëhet 522 lekë në muaj.
- Shpërblimi prej 500 lekë në muaj sipas pikës 8 dhe 11 bëhet 870 lekë në muaj.
- Shpërblimi i menjëhershëm sipas pikës 13, nga 20 mijë lekë bëhet 34 800 lekë.

2. Rritja e shpërblimit të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, në vartësi të indeksit të çmimeve dhe të inflacionit të bëhet në fillim të çdo viti.

3. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondi i akorduar për këtë qëllim për Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Buxhetin e Shtetit për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.1.1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M Nr.233, datë 10. 4.1998

PËR ZBATIMIN E LIGJIT “PËR STATUSIN E JETIMIT”

Në zbatim të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Statusi i jetimit jepet nga Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale.
2. Për dhënien e statusit të jetimit, në Administratën e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale ngrihet një komision specialistësh në nivel drejtorie, në përbërje të të cilit të jetë edhe një përfaqësues i Shoqatës së Jetimëve të Shqipërisë. Kryetari i këtij komisioni është Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.
3. Statusi i jetimit jepet në bazë të dokumentacionit që vërteton kriteret e vendosura në nenin 1 të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”.

4. Jetimët pretendues për të fituar statusin e jetimit duhet të dorëzojnë në seksionin përkatës të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore këto dokumente:

- a) certifikatën e lindjes së personit;
- b) dokumentin që vërteton trajtimin e tyre nga institucionet publike ose private të përkujdesit shoqëror (shtëpitë e foshnjës dhe fëmijës), nëse janë të sistemuar në këto institucione;
- c) certifikatën e vdekjes të të dy prindërve, nëse asnjëri prej tyre nuk është gjallë;
- d) vendimin e gjykatës të formës së prerë, për rastin e heqjes të së drejtës prindërore të të dy prindërve ose të njërit prind, kur prindi tjetër nuk jeton;
- e) vendimin e gjykatës që e deklaron të braktisur fëmijën nga të dy prindërit ose nga njëri prind, kur prindi tjetër nuk jeton.

Për rastet e përcaktuara në shkronjën “d” dhe “e” duhet të dorëzohet edhe certifikata e vdekjes për prindin që nuk jeton.

5. Personat jetimë, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr.8135 “Për statusin e jetimit” dhe kanë kaluar moshën 25 vjeç, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, për të përfituar statusin e jetimit, duhet të jenë përfitues të ndihmës ekonomike dhe të jenë të pastrehë sipas përcaktimit të bërë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.49, datë 29.1.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”. Kur vërtetohet ndryshimi i situatës ekonomike dhe të strehimit të personit jetim, ai nuk përfiton më nga statusi i jetimit.

6. Komisioni, për dhënien e statusit të jetimit, shqyrton dhe merr vendim lidhur me dhënien e statusit të jetimit sipas listës së paraqitur nga administratat rajonale të shërbimeve sociale, pasi këto të fundit të kenë verifikuar listat e paraqitura nga seksionet e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore në bashki e komuna.

7. Jetimët përfitues të statusit të jetimit, që mbarojnë shkollat e mesme e të larta, jetojnë në konvikte dhe janë pa asnjë të ardhur, trajtohen me ndihmë ekonomike, duke u konsideruar si kryefamiljarë (në masën 95% të nivelit bazë të pagesës së papunësisë) në seksionet përkatëse të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore deri në zënien e tyre me punë.

8. Jetimëve që përfitojnë statusin e jetimit, gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit të detyruar ushtarak u jepet një kuotë suplementare nga Ministria e Mbrojtjes në masën 1000 lekë në muaj.

9. Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim me Shoqatën e Jetimëve të Shqipërisë, përgatisin modelin e librezës së jetimit, e cila miratohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas. Libreza lëshohet nga Administrata e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale.

10. Efektet financiare për trajtimin me kuotë suplementare të ushtarëve jetimë gjatë kohës së kryerjes së shërbimit të detyruar ushtarak përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Për çdo shpërdorim në favoret dhe lehtësitë që përfitohen nga ligji “Për statusin e jetimit”, personit përgjegjës i merret libreza e jetimit për një vit dhe, kur është rasti, organi që e konstaton shkeljen, bën kallëzim për ndjekje penale.

12. Ngarkohen ministritë përkatëse të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.239, datë 10.4.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.598,
DATË 30.12.1997 “PËR ADMINISTRIMIN DHE SHITJEN E MALLRAVE TË
KONFISKUARA NË BAZË TË LIGJIT NR.8262, DATË 15.12.1997 “PËR
VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANIT DHE TË PIJEVE
ALKOOLIKE DHE PËR NGJYROSJEN E NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS””**

Në zbatim të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.598, datë 30.12.1997 “Për administrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në bazë të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës””, pika 10 ndryshohet si vijon:

“Banka e Shqipërisë të marrë masa për prodhimin e pullave adezive fiskale, sipas formularit të miratuar nga Ministria e Financave, të cilat do të vendosen nga DPRSH-ja mbi çdo paketë ose shishe të pijeve alkoolike të konfiskuara, para se ato t’u shiten fituesve të ankandit.

Gjatë periudhës deri në prodhimin e pullave adezive fiskale ngarkohet DPRSH-ja të vendosë pullë mbi çdo paketë cigareje ose shishe të pijeve alkoolike të konfiskuara, para se ato t’u shiten fituesve të ankandit”.

2. Pika 13 ndryshohet si vijon:

“Ankandi të zhvillohet brenda 15 ditëve-punë, nga data e depozimit të mallrave pranë DPRSH-së apo degëve të saj në rrethe, apo pas kryerjes së veprimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi”.

3. Pika 20 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.240, datë 10.4.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.910,
DATË 30.12.1996 “PËR KRIJIMIN E SEKRETARIATIT TEKNIK
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.910, datë 30.12.1996, pika 1 ndryshon si vijon:

“Krijimi i Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, si organ ekzekutiv i tij, i përfshirë në strukturën organizative të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Veprimtaria e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit përcaktohet me rregullore të veçantë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit”.

2. Pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.910, datë 30.12. 1996 shfuqizohet.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.244, datë 20.3.1998

**PËR KËSHILLIN E POLITIKËS SHKENCORE DHE TË ZHVILLIMIT
TEKNOLOGJIK**

Në zbatim të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik” dhe të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e Këshillit të politikës shkencore dhe zhvillimit teknologjik pranë Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i politikës shkencore dhe i zhvillimit teknologjik kryen këto detyra kryesore:

- Përcakton dhe drejton përparësitë e politikës shkencore e të zhvillimit teknologjik, të përshtatshëm për zhvillimin ekonomiko-shoqëror dhe për programet e kërkimit që lidhen me të.

- Jep mendimin për projektligjet dhe projektvendimet për veprimtarinë shkencore e teknologjike, që i paraqiten për miratim Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave.

- Bën vlerësimin periodik të arritjeve të politikës shkencore dhe të zhvillimit teknologjik.

- Përcakton detyrat për organet shtetërore për zhvillimin dhe përdorimin e potencialeve shkencore.

- Krijon komisione dhe grupe pune të përhershme për probleme të caktuara.

3. Këshilli i politikës shkencore dhe i zhvillimit teknologjik kryesohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe ka në përbërjen e tij Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrin e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrin e Shtetit pranë Kryeministrit, Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrin e Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe 7 shkencëtarë të shquar, që caktohen nga Kryetari i Këshillit të Politikës Shkencore dhe Zhvillimit Teknologjik.

4. Pranë Këshillit të politikave për zhvillimin teknologjik funksionon sekretaria e këtij

Këshilli, e cila kryen funksione organizative dhe përbëhet nga punonjës të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilët caktohen në këtë funksion nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrë udhëzimet përkatëse në bazë dhe për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.424, datë 6.8.1993 dhe nr.158, datë 7.4.1995 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.246, datë 10.4.1998

PËR KRIJIMIN E DREJTORISË SË KONTABILITETIT PRANË
MINISTRISË SË FINANCEVE

Në mbështetje të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në strukturën e Ministrisë së Financave shtohet Drejtoria e Kontabilitetit me objekt kryesor të veprimtarisë:

- udhëheqjen metodologjike dhe përgatitjen e projekteve për probleme të kontabilitetit;
- ndjekjen e problemeve që dalin nga zbatimi i planit kontabël të përgjithshëm në të gjitha subjektet pjesëmarrëse në ekonomi, persona fizikë a juridikë privatë dhe shtetërorë;
- aplikimin dhe ndjekjen e problemeve që dalin nga zbatimi i planit kontabël në institucionet qendrore dhe lokale;
- hartimin dhe ndjekjen e aplikimit të planit kontabël të shtetit;
- ndihmë e konsulencë për problemet e kontabilitetit në të gjitha nivelet e organeve shtetërore;
- konsolidimin e bilancit të pasurisë së shtetit në të gjithë vendin, për një informacion më të saktë kontabël në shërbim të qeverisë, për një administrim të përgjithshëm të balanceve kontabël dhe një bilanc të konsoliduar për rrethet e prefekturat; për kryerjen e një analize profesionale të informacionit kontabël në bazë dhe në qendër.

2. Struktura organizative dhe personeli i Drejtorisë së Kontabilitetit përbëhet nga drejtori, dy përgjegjës sektori dhe 6 specialistë, në perspektivë me një shtrirje sipas nevojave nëpër rrethe.

3. Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit përfshihet në njërin nga sektorët e Drejtorisë së Kontabilitetit.

4. Sektori i kontabilitetit publik në përbërje të drejtorisë së thesarit suprimohet.

5. Pagat dhe shpërblimet e punonjësve të kësaj drejtorie të jenë të njëjta me ato të Drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit të kësaj ministrie dhe të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1998.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.247, datë 4.4.1998

**PËR NEGOCIMIN E NDRYSHIMIT TË NDËRMJETËSVE FINANCIARË NË
MARRËVESHJET EKZISTUESE TË KREDIVE DHE NDIHMAVE TË HUAJA**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autorizohet Ministria e Financave të negociojë në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, me donatorët/kreditorët e huaj për ndryshimin e ndërmjetësve financiarë brenda vendit, të përcaktuar në marrëveshjet ekzistuese të ndihma/kredive për mbështetjen e sektorit privat. Ndërmjetësit e rinj do të jenë bankat tregtare me kapital tërësisht ose pjesërisht shtetëror, bankat tregtare private, vendase ose të huaja dhe institucionet e tjera financiare, private a publike, të licencuara për dhënie kredie ose pjesëmarrje me fondet e veta në kapitalin e shoqërive tregtare.

2. Zgjedhja e ndërmjetësve financiarë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi bëhet mbi bazën e konkurrimit mes atyre që përmbushin normat dhe standardet e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë për dhënie huaje. Për këtë Ministria e Financave kërkon nga Banka e Shqipërisë një konfirmim me shkrim për vlerësimin dhe klasifikimin e ndërmjetësve financiarë të licencuar e mbikëqyrur prej saj, si dhe një opinion për ndërmjetësit që investojnë ose kreditojnë në sektorin privat kapitalet e veta.

3. Të gjitha huatë dhe ndihmat e marra nga qeveria shqiptare për mbështetjen me kredi të sektorit privat brenda vendit, në bazë të marrëveshjes ekzistuese, do të konsiderohen ndihma dhe kredi të marra nga qeveria shqiptare. Në të gjitha rastet Ministria e Financave, në emër të qeverisë shqiptare lidh marrëveshje huaje me ndërmjetësit financiarë të zgjedhur prej saj dhe të pranuar nga donatorët/kreditorët. Kushtet e nënhuasë janë në çdo rast ato të përcaktuara në marrëveshjet e ndihmave/kredive të lidhura me donatorët, kurse risku i dhënies së huasë brenda vendit ndahet ndërmjet qeverisë dhe ndërmjetësve financiarë në varësi nga lloji i riskut.

4. Nënhuatë e dhëna deri tani nga ndërmjetësit financiarë, të përcaktuara në marrëveshjet ekzistuese të ndihma/kredive, të transferohen te ndërmjetësit e rinj, të cilët marrin përsipër vazhdimin e programeve. Nëse ndërmjetësit e rinj nuk marrin përsipër portofolin e huave të dhëna më parë, atëherë transferimi tek ato i pjesës së fondeve të papërdorura/padisbursuara do të bëhet me kushte tregtare.

5. Ministria e Financave, në bashkëpunim me donatorët/kreditorët e huaj dhe me ministritë/institucionet e tjera të vendit, deri në fund të muajit prill të vitit 1998, të përfundojë amendamentet e marrëveshjes ekzistuese të ndihma/kredive lidhur me ndryshimin e ndërmjetësve financiarë dhe të marrëdhënieve të qeverisë shqiptare si huamarrëse me huadhënësit e huaj dhe ndërmjetësit financiarë brenda vendit.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.250, datë 30.4.1998

**PËR DHËNIE ASISTENCE LIGJORE KOMPANISË “DELOITTE & TOUCHE”
GJATË PROCESIT TË LIKUIDIMIT TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE**

Me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kompanisë administruese “Deloitte & Touche”, për procesin e likuidimit të shoqërive tregtare, që kanë grumbulluar kapitale nga publiku i gjerë, i sigurohet asistencë ligjore deri në fund të vitit 1998.

2. Asistenca ligjore jepet për lidhjen e kontratave të shitjes, për vërtetimin dhe qartësimin e pronësisë së objekteve të shoqërive huamarrëse dhe për angazhimin në proceset gjyqësore që mund të lindin gjatë likuidimit të shoqërive huamarrëse.

3. Grupit mbikëqyrës, në organikën analitike të tij, të përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.396, datë 26.9.1997, për plotësimin e detyrave të caktuara në pikën 2 të këtij vendimi, i shtohen 3 juristë.

4. Paga bazë mujore e juristëve që do të aktivizohen në ndihmë të kompanisë “Deloitte & Touche” të jetë 25-30 mijë lekë në muaj dhe të përcaktohet nga një grup mbikëqyrës. Fondi i pagave prej 900 mijë lekësh përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në planin e vitit 1998.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe grupi mbikëqyrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.267, datë 9.5.1998

**PËR NDARJEN NGA BASHKËSIA EKONOMIKE “ALBBAKËR” DHE DALJEN
NJËSI MË VETE TË UZINËS SË KABLLOVE NË SHKODËR DHE UZINËS
ELEKTROMEKANIKE NË SHKODËR**

Me propozimin Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Uzina e kabllave në Shkodër kalon nga vartësia e bashkësisë ekonomike “Albbakër” në vartësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Uzina elektromekanike në Shkodër kalon nga vartësia e bashkësisë ekonomike “Albbakër” në vartësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.271, datë 9.5.1998

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TIP TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

Në zbatim të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7296, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore që i bashkëngjitet këtij vendimi, të cilat do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri anonime.

2. Për shoqëritë anonime që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në sektorë me rëndësi të veçantë të ekonomisë, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka kompetencë t’a ndryshojë këtë statut në përputhje me ligjin për shoqërinë tregtare.

Sektorët me rëndësi të veçantë janë sektorët e përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura private dhe privatizimit”.

3. Për shoqëritë anonime të regjistruara duhet të kryhet depozitimi në regjistrin tregtar i ndryshimit të statutit sipas përcaktimeve të statutit tip të miratuar në këtë vendim.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.356, datë 12.6.1995 “Për miratimin e akteve tip të themelimit të shoqërive shtetërore”, si dhe vendimi nr.519, datë 25.9.1995 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.356, datë 12.6.1995 “Për miratimin e akteve tip të themelimit të shoqërive shtetërore”” shfuqizohen.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUT I SHOQËRISË ANONIME

Neni 1

Emërtimi dhe selia

Shoqëria anonime krijohet nga transformimi i ndërmarrjes shtetërore _____.
Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet sh.a. _____.
Selia e shoqërisë është në adresë _____.

Neni 2

Objekti i shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është _____. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është _____ lekë.
Nga kjo vlera e trullit është _____ lekë. Numri i aksioneve është _____.
Vlera nominale e aksionit është 1000 lekë.

Neni 4

Transferimi i aksioneve në rast privatizimi

Transferimi i aksioneve në rastin e privatizimit do të kryhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në bazë të legjislacionit në fuqi për privatizimin.

Neni 5

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Këshilli mbikëqyrës
2. Drejtori

Neni 6

Këshilli mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga _____ (_____) anëtarë. Anëtarët e keshillit mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 4 (katër) vjet. Anëtarët e keshillit mbikëqyrës janë të gjithë të rizgjedhshëm. Ata mund të revokohen nga titullari i organit që i ka emëruar për shkaqe të përligjura.

3. Anëtarët e keshillit mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

4. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të keshillit mbikëqyrës mbeten bosh, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj.

Anëtari i këshillit mbikëqyrës i emëruar me zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

5. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1(një) këshill mbikëqyrës të shoqërive anonime që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të moshës mbi 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç nuk mund të jenë më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të këshillit mbikëqyrës. Nëse ky raport tejkalohet, anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 7

Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një anëtar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata zgjidhen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli mbikëqyrës mund të ngarkojë një person si sekretar edhe jashtë anëtarëve të tij.

Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e këshillit mbikëqyrës drejtohen nga zëvendëskryetari.

Neni 8

Vendimet e këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës mbledhet sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e këshillit mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, kur drejtorja ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët mund të thërrasin mbledhjen e këshillit mbikëqyrës, duke i përcaktuar rendin e ditës. Në parim thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara, me letër, telegram, teleks ose faks. Por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe me gojë dhe pa afat, nëse anëtarët e këshillit mbikëqyrës do ta pranojnë atë. Çdo thirrje duhet të përcaktojë rendin e ditës.

Mbledhja e këshillit mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në thirrje. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm ose jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, në rast barazimi votash, ajo e kryetarit është përcaktuese. Këshilli mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e këshillit mbikëqyrës evidentohen, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi nga kryetari dhe një anëtar i këshillit ose në mungesë të tij, nga dy anëtarë të këshillit mbikëqyrës.

Kopjet e vendimeve vërtetohen nga kryetari ose zëvendëskryetari i këshillit mbikëqyrës.

Neni 9

Kompetencat e këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë

nga drejtoria dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që mund të kryhen nga drejtoria pa autorizimin e këshillit mbikëqyrës.

2. Këshilli mbikëqyrës emëron drejtorinë. Këshilli mbikëqyrës cakton njërin prej anëtarëve të drejtorisë me cilësinë e drejtorit.

3. Me emërimin e anëtarëve të drejtorisë, këshilli mbikëqyrës lidh kontrata me ta për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

4. Këshilli mbikëqyrës, autorizon drejtorinë që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 12 dhe 13 të statutit.

5. Këshilli mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole, që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

6. Drejtoria i paraqet raport këshillit mbikëqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, drejtoria duhet t'i paraqesë këshillit mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

7. Këshilli mbikëqyrës i propozon Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit lidhur me këtë çështje:

a) përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;

b) kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;

c) hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë;

d) shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë;

e) krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera;

f) marrjen e huave afatmesme, afatgjata;

g) si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Drejtoria

1. Shoqëria administrohet nga drejtoria, e cila mund të përbëhet nga një ose disa anëtarë. Numri i anëtarëve të drejtorisë caktohet nga këshilli mbikëqyrës me një vendim të tij.

2. Drejtoria emërohet nga këshilli mbikëqyrës kur për të janë dakord jo më pak se 2/3 (dy të tretat) e gjithë anëtarëve të këtij këshilli.

3. Anëtarët e drejtorisë janë persona fizikë, në të kundërt emërimi i tyre është i pavlefshëm. Ata mund të zgjidhen edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i këshillit mbikëqyrës emërohet anëtar i drejtorisë, mandati i tij në këshillin mbikëqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet anëtar drejtorie ose drejtor në më shumë se një shoqëri. Anëtarët e drejtorisë mund të shkarkohen nga këshilli mbikëqyrës për shkaqe të përligjura. Në rastin kur i interesuari ka lidhur kontratë punësimi me shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i anëtarit të drejtorisë nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës.

4. Anëtarët e drejtorisë emërohen për një periudhë kohe prej 4 (katër) vjetësh. Në rastet e pushimeve dhe mungesave të zgjatura, këshilli mbikëqyrës bën zëvendësimin e tyre.

Anëtarët e drejtorisë janë të riemërueshëm. Ata nuk mund të jenë mbi moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç. Anëtar i drejtorisë që mbush moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë)

vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

5. Paga e anëtarëve të drejtorisë caktohet nga këshilli mbikëqyrës në aktin e emërimit të tyre.

Neni 12

Kompetencat e drejtorisë

1. Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.

2. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorisë të nënshkruara nga anëtari me cilësinë e drejtorit, edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit, kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorisë kapërcente objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

3. Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve duhet të nënshkruhen nga anëtari me cilësinë e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

4. Drejtoria merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, kur janë prezent jo më pak se gjysma e anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash, vota e anëtarit të caktuar me cilësinë e drejtorit është përcaktuese.

5. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlerë mbi 2 (dy) milionë lekë bëhet me autorizim të këshillit mbikëqyrës.

6. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga këshilli mbikëqyrës.

7. Drejtoria bën strukturën e organizimit të shoqërisë, të cilën e miraton këshilli mbikëqyrës.

Neni 13

Marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe drejtorisë ose të një anëtari të këshillit mbikëqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe anëtarëve të drejtorisë ose një anëtari të këshillit mbikëqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të këshillit mbikëqyrës. Përcaktimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i këshillit mbikëqyrës është dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës të një shoqërie tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshje. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhet në kushte normale. Anëtari i drejtorisë ose i këshillit mbikëqyrës i interesuar duhet të njoftojë këshillin mbikëqyrës për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i këshillit mbikëqyrës nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

Neni 14

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga (_____) ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga aksionmbajtësi i vetëm dhe që kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 15
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
Përfshihet ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar deri më 31 dhjetor.

Neni 16
Inventari – llogari vjetore

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbylljen e ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar. Drejtoria përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 17
Rezultati ushtrimor dhe përcaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm. Nga fitimet e ushtrimit, të pakësuara kur është rasti me humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% (pesë për qind) për të krijuar rezervën e domosdoshme. Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme nuk është e detyrueshme, kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon për një arsye çfarëdo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit.

Përdorimi i fitimit pas zbritjes së rezervës ligjore bëhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Neni 18
Emërimi i anëtarëve të parë të këshillit mbikëqyrës

Si anëtarë të parë të këshillit mbikëqyrës emërohen:

1. _____
2. _____
3. _____

Neni 19
Emërimi i ekspertit kontabël të parë të autorizuar

Ekspert i (të) parë kontabël i (të) autorizuar emërohet (n) :

1. _____
2. _____
3. _____

Neni 20
Asambleja e përgjithshme

Të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme të parashikuara nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, që nuk janë shprehur në këtë statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit me cilësinë e aksionerit të vetëm.

Neni 21
Dispozita e fundit

Në një afat prej 6 (gjashtë) muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, drejtor i shoqërisë do të jetë drejtori i ish – ndërmarrjes shtetërore. Gjatë këtij afati ai mund të shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit veç për shkaqe të përligjura.

Neni 22

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

V E N D I M
Nr.279, datë 9.5.1998

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare””, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, të jetë:

- 3 anëtarë për shoqëritë që kanë deri në 1000 punonjës;
- 6 anëtarë për shoqëritë që kanë mbi 1000 deri 2000 punonjës;
- 9 anëtarë për shoqëritë që kanë mbi 2000 punonjës.

2. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës duhet të jenë specialistë të ministrive, departamenteve, drejtorive ose institucioneve të tjera, që varen drejtpërdrejtë nga Këshilli i Ministrave, si dhe organeve përkatëse të pushtetit lokal, të cilat përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore.

Në këshillat mbikëqyrës mund të emërohen edhe punonjës të bankave, të institucioneve kërkimore-shkencore, të universiteteve, si dhe persona që gëzojnë autoritet në fusha të caktuara.

Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës punonjës të organeve qendrore a lokale që kryejnë funksion kontroll-revizionimi, persona që janë emëruar në drejtoritë e shoqërive tregtare ose janë drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare, persona që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafin e dytë të kësaj pike.

Pjesëmarrja në këshillin mbikëqyrës do të bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 107 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

3. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës përfitojnë:

- Shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës sa 30 përqind e pagesës mujore të drejtorit të shoqërisë për kryetarin dhe nga 20 përqind për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës.

- Shpërblim për shërbime ose detyra që u besohen anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, që do të caktohet nga këshilli mbikëqyrës dhe do të miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës fillon nga mbledhja e parë e tij, përballohet nga vetë shoqëritë dhe caktohet sipas kriterëve të mësipërme me vendim të veçantë në mbledhjen e parë të këshillit mbikëqyrës.

5. Në pikën 1, rreshti i dytë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.720, datë 29.11.1995 “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”, hiqen fjalët “këshilli mbikëqyrës”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.348, datë 3.7.1995 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive shtetërore”, si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe organet që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në vartësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M **Nr.280, datë 9.5.1998**

SHPLLJEN SI OBJEKT I RËNDËSISË SË VEÇANTË SHTETËRORE TË AEROPORTIT TË RINASIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe në mbështetje të nenit 3 shkronja “a” të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen si objekt të rëndësishëm shtetëror të Aeroportit të Rinasit dhe marrjen në ruajtje nga policia e objekteve të Ministrisë së Rendit Publik.

2. Ministrisë së Rendit Publik, për ruajtjen e këtij objekti, i shtohen në organikë 52 punonjës policie.

3. Shpenzimet në shumën prej 25 milionë lekësh për ruajtjen e këtij objekti të përballohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, nga të ardhurat që realizohen nga taksat e ulje-ngritjes dhe të mbikalimeve ajrore të avionëve në përputhje me nenin 3 paragrafi i fundit i ligjit nr.8248, datë 6.10.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë””.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik që, me përfundimin e rrethimit të territorit të Aeroportit të Rinasit, të reduktojnë

numrin e punonjësve të policisë për ruajtjen e këtij objekti dhe shpenzimet e ruajtjes të përballohen nga ndërmarrja e Albtransportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.283, datë 9.5.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 356,
DATË 10. 9. 1997 “PËR EMËRIMIN E GUVERNATORËVE DHE
ZËVENDËSGUVERNATORËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË
INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE FINANCIARE E TË ZHVILLIMIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.356, datë 10.9.1997 “Për emërimin e guvernatorëve dhe zëvendësguvernatorëve të Republikës së Shqipërisë pranë institucioneve ndërkombëtare financiare e të zhvillimit”, në pikën 11 fjalët “Ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.298, datë 19.5.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.203,
DATË 26.3.1998 “PËR NËNSHKRIMIN E KARTËS EUROPIANE TË AUTONOMISË
LOKALE”**

Me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 26.3.1998, bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet si vijon:

“Të nënshkruhet Karta Europiane e Autonomisë Lokale”.

- Pika 2 shfuqizohet.

- Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Autorizohet Ministri i Pushtetit Lokal për nënshkrimin e Kartës Europiane të

Autonomisë Lokale”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.300, datë 19.5.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.609,
DATË 24.12.1997 “PËR SHFAQJEN E INTERESIT TË QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË SHQIPËRISË PËR PROJEKTET E ASISTENCËS TEKNIKE TË FINANCUARA
NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË ITALISË”**

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 24.12.1997 shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet si vijon:

“a. Shërbime për punëmarrësit, me kusht që partneri shqiptar të identifikohet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale”.

2. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për komunikimin e këtij vendimi palës italiane.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.307, datë 19.5.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.182,
DATË 25.4.1995 “PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE”, NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR.21, DATË 31.1.1997**

Në bazë të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.152, datë 25.4.1995, pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave nga grosistët caktohet deri në 12 për qind mbi çmimin fillestar të blerjes CIF, konvertuar në lekë sipas kursit përkatës mesatar për çdo 6-mujor që njoftohet nga Banka e Shqipërisë.

Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë i barnave nga prodhuesit e vendit caktohet deri në 17 për qind mbi koston e prodhimit”.

2. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me pakicë të barnave nga farmacitë e rrjetit të hapur, caktohet deri në 27 për qind mbi çmimin e blerjes që del pas shtesës, që i bëhet atij sipas pikës 1 të këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M Nr.320, datë 23.5.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.549, DATË 7.11.1994 “PËR DIETAT E NËPUNËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDBANIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për disa dispozita kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.549, datë 7.11.1994, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë fjalët “por pa kaluar 800 lekë në ditë dhe jo më pak se 400 lekë në ditë” zëvendësohen me fjalët “por pa kaluar 1400 lekë në ditë dhe jo më pak se 700 lekë në ditë, kurse punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ata të revizionit të ministrive dhe institucioneve qendrore, kur qëndrojnë me shërbime pa ndërprerje jo më pak se 5 ditë, përfitojnë dietë jo më shumë se 1600 lekë në ditë dhe jo më pak se 700 lekë në ditë”.

Në paragrafin e dytë fjalët “por pa kaluar 600 lekë” zëvendësohen me fjalët “por pa kaluar 1000 lekë”.

2. Në pikën 4, fjalët “në masën 600 lekë në ditë” zëvendësohen me fjalët “1100 lekë në ditë”.

3. Në fund të pikës 5, fjalët “në masën 250 lekë” zëvendësohen me fjalët “në masën 400 lekë”.

4. Në fund të pikës 7, fjalët “në masën 400 lekë” zëvendësohen me fjalët “në masën 700 lekë në ditë”.

5. Në pikën 8, paragrafi i tretë, fjalët “përfitojnë dietë në masën 200 lekë në ditë dhe shpenzimet e udhëtimit” zëvendësohen me fjalët “përfitojnë dietë në masën 400 lekë në ditë dhe shpenzimet e udhëtimit” dhe fjalët përfitojnë dietë në masën 300 lekë në ditë “zëvendësohen me fjalët “përfitojnë dietë në masën 500 lekë në ditë”.

Në fund të pikës 8 fjalët “prej 100 lekësh në ditë” zëvendësohen me fjalët “prej 200 lekësh në ditë”.

6. Në pikën 9, në paragrafin e parë dhe të dytë “shuma prej 800 lekësh në ditë” zëvendësohet me “shumën 1400 lekë në ditë.”

7. Efektet financiare të këtyre ndryshimeve për institucionet buxhetore të përballohen brenda shpenzimeve operative të miratuara në buxhetin e këtij viti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.328, datë 2.6.1998

PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE ISH-PRONARËVE

Në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve të jetë me këtë përbërje:

- Kryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve.
- Zëvendëskryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve.
- Zëvendësministri i Drejtësisë.
- Zëvendësministri i Pushtetit Lokal.
- Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.
- Drejtori i Institutit të Urbanistikës.
- Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave.
- Drejtori i Drejtorisë së Transformimit dhe Privatizimit në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
- Kryeregjistruesi i Zyrës së Pasurive të Paluajtshme.
- Zëvendësdrejtori i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.
- Zëvendëskryetari i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit.

2. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve mbledhet me kërkesën e kryetarit të tij dhe, në mungesë të tij, nga nënkryetari i komitetit, jo më pak se një herë në muaj, për trajtimin e problemeve që lidhen me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve.

Mbledhja e komitetit konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të këtij komiteti.

Vendimet e komitetit miratohen nga më shumë se gjysma e anëtarëve të komitetit të pranishëm në mbledhje.

3. Tabela që i bashkëngjitet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 1.8.1994

“Për përbërjen e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.332, datë 2.6.1998

PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË STEMËS SË POLICISË

Në zbatim të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 “Për policinë e rendit”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e uniformës dhe të stemës së policisë sipas albumit që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Llojet e uniformës së policisë për oficerët, nënoficerët dhe policët e veshjes blu janë:

- a) uniforma bazë I, përbërja terital;
- b) uniforma bazë II, përbërja dok poliestër;
- c) uniforma verore;
- d) uniforma e stërvitjes dhe e kohës së luftës;
- e) uniforma e pikës “a”, duke i shtuar disa elementë, do të përdoret edhe si uniformë ceremoniale.

2. Ministri i Rendit Publik ka në kompetencë të miratojë:

- rregulloren e uniformës së policisë;
- shenjat dalluese të shërbimeve të policisë (me përjashtim të emblemës), si dhe ornamentet dekorative të uniformës ceremoniale;

- uniformat e shërbimeve të veçanta të policisë (qarkullimi rrugor, MNZ, helikopterët, mjetet lundruese etj.) dhe pajisjet speciale të tyre;

- rregulla të posaçme për stimulimin e mbajtjes mirë të uniformës;

- ndryshimin në elemente të veçanta të uniformës sipas ndryshimeve të strukturës e perspektivës;

- ndryshime të mundshme të propozuara nga specialistë europianë në kuadrin e bashkëpunimit me misionin “MAPE” dhe zbatimin e programit “PHARE” (pjesa për policinë).

3. Lejimin e përdorimit të uniformës ekzistuese dhe të uniformës së re deri në datën 30. 6. 1999.

4. Ministria e Rendit Publik, brenda vitit 1998, të rishikojë dhe të përmirësojë modelet ekzistuese të uniformës së shërbimeve të tjera të policisë (FNSH, forcat speciale, Akademia e Rendit, Garda e Republikës etj.) dhe t’i paraqesë ato për miratim.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.194, datë 29.5.1989 “Për uniformën e re të policisë popullore të RPSSH-së”, si dhe të gjitha aktet e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.333, datë 2.6.1998

PËR MIRATIMIN E NORMËS SË VESHMBATHJES PËR POLICINË

Me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e normës së veshmbathjes për oficerë, nënoficerë dhe policë të veshjes blu, sipas pasqyrës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ministria e Rendit Publik, brenda vitit 1998, të ripunojë dhe të paraqesë për miratim normat e veshmbathjes për të gjitha strukturat e saj.
3. Ministri i Rendit Publik ka në kompetencë të miratojë:
 - a) normat e materialeve të veshmbathjes që janë inventar i repartit;
 - b) normat e materialeve të pastrimit e të mirëmbajtjes së objekteve të veshmbathjes;
 - c) normat e pajimeve të kafshëve;
 - d) normat e veshmbathjes për të paraburgosurit;
 - e) zëvendësimet në materialet e veshmbathjes brenda vleftës së normës;
 - f) normat për uniformat e veçanta.
4. Efektet ekonomike që rrjedhin nga ky vendim, përballohen nga fondet e programit PHARE (pjesa për policinë) dhe nga Buxheti i Shtetit i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.194, datë 29.5.1989, si dhe të gjitha aktet e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**NORMAT E VESHMBATHJES PËR OFICERË, NËNOFICERË E POLICË TË VESHJES
BLU**

	Sasia	Vitet
Xhup sintetik blu	1	3
Xhup trikoton blu	1	3
Kostum terital (xhaket 2, pantallona 2 kapele)		
Për oficerët e shtabit të lartë	1	2.5
Për oficerë n/oficerë trupë policie	1	3
Pantallona vere	2	2
Këmishë me mëngë të gjata	2	1
Këmishë me mëngë të shkurtra	2	1
Çorape	2	1
Kravatë	2	3
Doreza meshini	1	6
Këpucë gjysma	1	0.8
Pulovër leshi	1	2
Rrip pantallonash	1	2
Rip mesi	1	6

Kostum doku poliestër	1	3
-Për oficerë , n/oficerë shtabi e lartë		
-Për oficer n/oficerë trupe policie	1	2.5
Kostum doku stërvitjeje	1	8
Këpucë me qafa trupe		
-Për oficerë, n/oficerë shtabi e lartë	1	3
-Për oficerë, n/oficerë trupe policie	1	2

V E N D I M
Nr.335, datë 2.6.1998

**PËR PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE PËR
DETYRIMET QË PREKIN BUXHETIN E SHTETIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore ndjekin zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet e institucioneve buxhetore të vartësisë së tyre. Detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore përballohen nga vetë institucioni brenda fondeve të miratuara për vitin buxhetor, sipas kritereve e procedurave që do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

2. Ministria e Financave me fondin që i vihet në dispozicion në buxhetin e çdo viti, zbaton vendimet gjyqësore që lidhen drejtpërdrejtë me detyrimet e Buxhetit të Shtetit dhe jo me detyrimet e institucioneve buxhetore. Në këto vendime përfshihen:

a) Vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me kthimin e vlerës për truallin e blerë nga qytetarët, por që në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, i rikthehen shtetit.

b) Vendimet gjyqësore për kthimin ish-pronarëve të objekteve të privatizuara mbas shtetëzimit, si dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ky veprim.

c) Vendimet gjyqësore që lidhen me kompensimin për burgimin ose dënimin e padrejtë.

d) Vendimet gjyqësore që lidhen me sekuestrimin e sendeve personale.

e) Vendimet gjyqësore që përcaktojnë shprehimisht detyrim të shtetit për shkaqe të tjera të parashikuara në ligje.

f) Vendimet e gjykatave ose arbitrazheve të huaja që përmbajnë detyrime për Buxhetin e Shtetit.

3. Ngarkohen Instituti i Integritetit të të Përndjekurve dhe Ministria e Financave, që brenda 6-mujorit të parë të vitit 1998, t'i paraqesin Këshillit të Ministrave projektin përkatës për kompensimin e pasurive të luajtshme të ish-të përndjekurve politikë.

4. Për vendimet gjyqësore që lidhen me nenin 6 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, ngarkohet Ministria e Financave që brenda 3-mujorit të tretë të vitit 1998 të përgatisë dhe të propozojë ndryshimet përkatëse të ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr.338, datë 23.5.1998

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.428, DATË 20.10.1997 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.429, DATË 30.8.1993 “PËR
KRIJIMIN E KOMITETIT QEVERTAR TË BISEDIMEVE TË BORXHIT TË
JASHTËM””**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.428, datë 20.10.1997, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, anëtar” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendëskryetar”.

2. Pas pikës 9 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Komiteti, për funksionimin e tij cakton një sekretar, të përbërë nga punonjës të Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë” .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**V E N D I M
Nr.340, datë 23.5.1998**

PËR KOMPETENCAT E BORDIT KOMBËTAR TË USHQIMEVE

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bordi Kombëtar i kontrollit të ushqimeve është organ këshillimi, konsultimi dhe koordinimi i të gjithë veprimtarisë së kontrollit ushqimor në Republikën e Shqipërisë.

2. Detyrat kryesore të Bordit Kombëtar të kontrollit të ushqimeve janë:

- Përcakton përparësitë e kontrollit ushqimor në Republikën e Shqipërisë.

- Bashkërendon veprimtarinë e përbashkët të organeve të kontrollit të ushqimit të parashikuara me ligj, si dhe ndërmjet strukturave të pushtetit qendror e lokal.

- Bashkërendon punën ndërmjet qendrave të referencës së kontrollit ushqimor, si dhe laboratorëve të ngarkuar me analizat e produkteve ushqimore, për shmangien e paralelizmave dhe mosmarrëveshjeve mes tyre.

- Sugjeron hartimin ose rishikimin e akteve nënligjore, urdhëresave, rregulloreve etj. dhe i shqyrton ato para paraqitjes për miratim në organet përkatëse.

- Bashkëpunon me organe të tjera, si ato shkencore, informative, edukative dhe arsimore, për të zhvilluar një interes e kuptim të plotë për cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve, si dhe për një kualifikim të vazhdueshëm në këtë fushë.

- Inkurajon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtare në fushën

e kontrollit ushqimor.

- Ndhmon në zgjidhjen e problemeve që ngrihen nga konsumatorët, prodhuesit dhe tregtarët nëpërmjet udhëzimeve e rekomandimeve në zbatim të ligjeve e vendimeve në fuqi.

3. Pranë Bordit Kombëtar të kontrollit të ushqimeve ngrihet sekretariati, i cili ngarkohet për bashkërendimin e punës ndërmjet pjesëmarrësve, organizimin e takimeve, përgatitjen e rendit të ditës, përgatitjen e dokumenteve dhe materialeve për shqyrtim, mbajtjen e korrespondencës brenda dhe jashtë vendit, mbajtjen e arkivit dhe kryerjen e të gjithave veprimtarive të nevojshme për funksionimin normal të Bordit Kombëtar të kontrollit të ushqimeve.

4. Sekretariati përbëhet nga dy sekretarë (një specialist në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe një specialist në Ministrinë e Shëndetësisë me seli të përkohshme në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit).

5. Bordi kombëtar i kontrollit të ushqimeve të mbledhet, si rregull, një herë në tre muaj. Takimet, problemet e trajtuara dhe detyrat e marra mbahen në arkivin e bordit.

Kryetari i Bordit informon rregullisht Kryetarin e Këshillit të Ministrave për zbatimin e kompetencave të ngarkuara me ligj.

6. Vendimet e Bordit merren me votim. Bordi mund të mbledhet kur numri i pjesëmarrësve të tij është jo më pak se 9 anëtarë. Vendimet e Bordit merren me shumicë absolute të të pranishmëve. Bordi mund të marrë vendime edhe në mungesë të kryetarit, i cili mund të autorizojë një anëtar bordi për ta zëvendësuar.

7. Kur një projekt miratohet nga Bordi, ai u parashtrohet për shqyrtim e miratim organeve përkatëse.

8. Çdo anëtar i Bordit, për pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.343, datë 5.6.1998

**PËR KALIMIN NË VARTËSI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË SHËRBIMIT
TË EKSPERTIMIT MJEKOLIGJOR**

Në zbatim të nenit 1 shkronja “e” dhe të nenit 2 të ligjit nr.7831, datë 9.5.1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shërbimi i ekspertimit mjekoligjor kalon nga vartësia e Ministrisë së Shëndetësisë në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministrisë së Shëndetësisë i pakësohen 22 veta nga numri i përgjithshëm i punonjësve, të cilët i shtohen Ministrisë së Drejtësisë.

3. Mjetet kryesore dhe pajisjet e derisotshme në dispozicion të shërbimit të ekspertizës mjekoligjore kalojnë si fond i Ministrisë së Drejtësisë.

4. Fondet buxhetore, të miratuara për këtë shërbim në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 1998, transferohen në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

5. Në strukturën organizative të Ministrisë së Drejtësisë krijohet sektori i shërbimit të

ekspertizës gjyqësore, për drejtimin dhe kontrollin administrativ të shërbimit.

6. Ekspertimi mjekoligjor realizohet nga shërbimi qendror mjekoligjor, me qendër në Tiranë, nga shërbimi mjekoligjor në rrethet ku kanë qendrën gjykatat e apelit dhe ekspertët e jashtëm në rrethet e tjera. Struktura dhe përbërja e këtij shërbimi përcaktohet nga Ministri i Drejtësisë.

7. Shërbimi qendror i ekspertizës mjekoligjore, veç funksionit të ekspertimit, ka për detyrë edhe:

- a) drejtimin operativ të shërbimit mjekoligjor në rrethe;
- b) aftësimin profesional të ekspertëve;
- c) organizimin e punës kërkimore studimore.

8. Shërbimi i ekspertizës mjekoligjore kryhet me ekspertë funksionarë dhe ekspertë të jashtëm. Ekspertët funksionarë dhe personeli ndihmës, ekzistues kryejnë veprimtarinë në shërbimin qendror të ekspertizës mjekoligjore dhe në rrethet ku e kanë qendrën gjykatat e apelit.

9. Kryeekspertët dhe ekspertët emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Drejtësisë, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë, kurse personeli tekniko-administrativ i shërbimit të ekspertizës nga kryeeksperti përkatës.

Ekspertët e jashtëm miratohen nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e kryeekspertit të shërbimit qendror dhe aktivizohen me kontratë.

Në shërbimin qendror mjekoligjor mund të aktivizohen si ekspertë të jashtëm dhe pedagogë efektivë të Qendrës Spitalore Universitare, specialistë të institucioneve shëndetësore etj.

Ekspertimi mjekoligjor në rrethe të tjera, deri në shtrirjen e plotë të shërbimit të ekspertizës, të vazhdojë të kryhet nga mjekët anatomopatologë me cilësinë e ekspertit të jashtëm.

10. Ekspertimi psikiatro-ligjor të vazhdojë të kryhet nga specialistët efektivë të institucioneve përkatëse mjekësore, me cilësinë e ekspertëve të jashtëm.

11. Ekspertët e jashtëm shpërblehen për punën faktike me vlerën e pagesës së një ore pune të ekspertit funksionar sipas normativave të miratuara për çdo lloj veprimi, me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Shëndetësisë. Për veprime të veçanta ekspertimi, mund të zbatohet edhe kriteri i shpërblimit fiks.

12. Ekspertët funksionarë të shërbimit mjekoligjor, me miratim të Ministrit të Drejtësisë, mund të lejohen të aktivizohen si pedagogë të jashtëm në institucionet arsimore.

13. Organizimi, kompetencat dhe veprimtaria e shërbimit të ekspertizës mjekoligjore përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

14. Shërbimi i ekspertimit mjekoligjor kryen veprime të ekspertimit me kërkesë të prokurorit, të policisë gjyqësore dhe me vendim të gjykatës lidhur me çështjet në shqyrtim.

Me kërkesë të personave të proceduar penalisht, palëve në procesin civil, mbrojtësve ose përfaqësuesve të tyre, kryhen veprime ekspertimi vetëm lidhur me mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre në një hetim ose gjykim të filluar.

15. Ekspertimi realizohet kundrejt shpërblimit nga organi ose subjekti kërkues sipas tarifave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë.

16. Marrëdhëniet ndërmjet ekspertizës mjekoligjore dhe institucioneve të tjera qendrore rregullohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të titullarit përkatës.

17. Marrëdhëniet e shërbimit të ekspertizës mjekoligjore me prokurorinë dhe gjykatën rregullohen në bazë të dispozitave të kodeve të procedurës penale dhe të asaj civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1.6.1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.347, datë 23.5.1998

**PËR SHKËPUTJEN NGA PUNA TË SUBJEKTEVE SPORTIVE PËR
PËRGATITJEN DHE PJESËMARRJEN E TYRE NË VEPRIMTARITË SPORTIVE
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në subjektet sportive hyjnë sportistët, trajnerët, mjekët sportivë, gjyqtarët dhe vëzhguesit.

2. Subjektet sportive të punësuar në institucione ose ndërmarrje shtetërore, si dhe nxënësit e studentët e shkollave shtetërore e private, lejohen të shkëputen nga veprimtaria e përditshme për ditët që lidhen me përgatitjen dhe pjesëmarrjen e ekipeve kombëtare në veprimtaritë sportive brenda ose jashtë vendit.

Personat juridikë privatë, të lejojnë subjektet sportive të punësuar pranë tyre, për pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive pa të drejtë page.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, t’i paraqesë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kalendarin e veprimtarive sportive brenda dhe jashtë vendit, kur subjektet sportive janë nxënës ose studentë.

3. Të punësuarit në institucione ose në ndërmarrje shtetërore pagën për këtë periudhë do ta marrin në institucionin përkatës, kurse të punësuarit në ndërmarrje ose institucione private në federatën që organizon veprimtarinë sportive.

4. Mungesat e nxënësve dhe studentëve, të shkaktuara nga grumbullimi për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive ndërkombëtare, konsiderohen të justifikuara dhe nuk përfshihen në numrin e përgjithshëm të tyre.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.188, datë 25.4.1995, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.350, datë 23.5.1998

**PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E DISA PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE DHE
KONSULLORE**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore

kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e Ambasadës të Republikës së Shqipërisë në Izrael. Selia e ambasadës të jetë në Tel- Aviv.
 2. Hapja e Zyrës së Përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në Bosnjë Hercegovinë. Selia e zyrës të jetë në Sarajevë.
 3. Hapja e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Republikën Italiane me seli në Bari.
 4. Hapja e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Republikën Greke me seli në Selanik.
 5. Mbyllja e Ambasadës të Republikës së Shqipërisë në Pakistan (Islamabad).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.380, datë 30.4.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.286, DATË 30.5.1994 “PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHTETIT NGA KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.405, DATË 15.8.1998

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994, në pikën 1 pas fjalëve “Mjetet e punës, lëndët e para, materialet” të shtohet fjala “karburantet”, kurse në pikën 4 fjala “karburantet” shfuqizohet.
 2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:
“Karburantet e sekuestruara që konsiderohen mall-rezervë e shtetit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, u shiten nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore institucioneve buxhetore, sipas çmimeve në fuqi dhe me ankand, kur institucionet buxhetore nuk paraqesin kërkesa për furnizim”.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.395, datë 24.6.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.235, DATË 10.4.1998 “PËR MIRATIMIN E PESË MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE TË RAUNDIT TË DYTË TË KËRKIMIT TË NAFTËS DHE GAZIT NË TOKË”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 10.4.1998 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “ONSHORE-2” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “ONSHORE - 3”.

2. Në pikën 3 fjalët “ONSHORE-2” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “ONSHORE - A”.

3. Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Ky vendim hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8297, datë 4.3.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, ndryshuar me ligjin nr.7853, datë 27.7.1994 “Për disa shtesa në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)””.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.397, datë 24.6.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.239, DATË 10.4.1998 “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.598, DATË 30.12.1997 “PËR ADMINISTRIMIN DHE SHITJEN E MALLRAVE TË KONFISKUARA NË BAZË TË LIGJIT NR.8262, DATË 15.12.1997 “PËR VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANIT E TË PIJEVE ALKOOLIKE DHE PËR NGJYROSJEN E NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS””

Në mbështetje të ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës”, me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.239, datë 10.4.1998, pika 1, paragrafi 3 ndryshon si vijon:

“Deri në çastin e furnizimit me këtë pullë nga Banka e Shqipërisë, por jo më vonë se data 31.7.1998, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore të bëjë shiritimin e kolive të cigareve me letër “Bergman” dhe të vendosë mbi të vulën e saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore pajis me pullën fiskale të konfiskimit subjektet fituese të ankandit, në sasi të barabartë me mallin e shitur”.

Në rastin kur:

a) Malli është i destinuar për tregun vendas, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore shoqëron mallin e shitur në magazinën e subjektit fitues apo në fabrikën me të cilën ka kontratë, për të vendosur pullat e konfiskimit.

b) Malli është i destinuar për eksport, vlera minimale e mallit të shitur në ankand të jetë mbi 1 milion USD, Drejoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore shoqëron mallin e shitur në pikën kufitare doganore, nga ku do të kryhet eksportimi i tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.398, datë 24.6.1998

**PËR KONTROLLIN FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË QË KANË MARRË
HUA NGA PUBLIKU I GJERË NËPËRMJET KOMPANISË “COOPERS &
LYBRAND”**

Në mbështetje të nenit 1 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëritë tregtare “Vefa Holding”, “Silva”, “Kamberi”, “Cenaj & Co” dhe “M.Leka”, subjekte të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, të cilat janë në proces administrimi, u nënshtrohen edhe kontrollit financiar nga kompania “Coopers & Lybrand”.

2. Kontrolli financiar i shoqërive tregtare, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të realizohet në dy faza me nga një kohëzgjatje nga 3 muaj secila dhe do të përfshijë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pozicionin financiar të shoqërisë, me detyrimet financiare për t'u paguar, me lëvizjen e parave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nxjerrjen e detyrimeve debitore dhe të detyrave të tjera të përcaktuara në kontratë.

Kontrolli financiar i librave dhe regjistrave të shoqërisë, balanceve kontabël apo i dokumenteve të tjera, kryhet nga periudha e fillimit të veprimtarisë së tyre deri në përfundim të administrimit.

3. Kompania “Coopers & Lybrand” me cilësinë e ekspertëve financiarë përbëhet nga këta persona:

Z. Rick Helsby
Z. Richard Coleman
Z. Roger Stanley
Z. Bill Cleghorn
Z. Steve Peters
Z. Keith Boyce
Z. Isabel Ong

4. “Coopers & Lybrand” për të realizuar detyrat në fushën e kontrollit të shoqërive huamarrëse, sipas kontratës bashkëlidhur, e cila është pjesë e pandarë e këtij vendimi, bashkëpunon me kompaninë administrative “Deloitte & Touche”, si dhe merr prej saj gjithë dokumentacionin e nevojshëm që i nevojitet.

5. Sipas kontratës, “Coopers & Lybrand” për të realizuar detyrat në fushën e kontrollit,

krahas stafit kryesor që ka në përbërje të tij, përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, aktivizon sipas nevojës dhe ekspertë kontabël të pavarur vendas. Lista e ekspertëve kontabël u vihet në dispozicion nga Grupi Mbikëqyrës duke i dhënë të drejtën personave që sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.178, datë 6.3.1998, janë caktuar në cilësinë e ekspertëve të përkohshëm. Pagesa e stafit lokal përballohet nga “Coopers & Lybrand”.

6. Grupi mbikëqyrës kërkon nga “Coopers & Lybrand” realizimin e sferës së shërbimeve të përcaktuara në kontratë, respektimin e afateve kohore për sigurimin e informacioneve të nevojshme si dhe zbatimin me rigorozitet të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Grupi i Mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.404, datë 1.7.1998

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PRIVATE**

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë lejen për funksionimin e institucionit arsimor privat, të nivelit të arsimit 8 vjeçar, “Shkolla shqiptaro-greke “Arsakio”” e fondacionit “Philekpedheftiki”, adresa “Rruga e Elbasanit”, blloku i vilave, Tiranë.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të kontrollojë procesin mësimor dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën arsimore të këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.405, datë 24.6.1998

**PËR LEHTËSIMIN E PAPUNËSISË NËPËRMJET ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË
PUNËVE PUBLIKE**

Në mbështetje të ligjit nr.7933, datë 17.5.1995 “Për punët publike”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qëllimi i zbatimit të programit të punëve publike është:

a) lehtësimi i papunësisë dhe i varfërisë në njësitë administrative lokale me problematike;

b) rritja e efektit dhe reduktimi i kostos së programeve shtetërore të mbështetjes me të ardhura;

c) përmirësimi i infrastrukturës dhe i kushteve të jetesës në njësitë administrative lokale;

d) rritja e mundësive për veprimtarinë ekonomike dhe për zhvillimin në njësitë administrative lokale;

e) mbështetja e veprimtarisë së organeve të pushtetit lokal.

2. Objekti i projekteve të punëve publike është:

a) ndërtimi, rikonstruksioni, riparimi, sistemimi dhe mirëmbajtja e elementeve të thjeshta të infrastrukturës;

b) krijimi, përmirësimi ose riparimi i mjediseve publike në qendra të banuara.

3. Shërbimi kombëtar i punësimit organizon, koordinon dhe drejton zbatimin e programit shtetëror të punëve publike.

Ky program kupton financimin, me fonde të buxhetit të shtetit, të veprimtarive që krijojnë vende të përkohshme pune, të thjeshta dhe shoqërisht të dobishme, në njësitë administrative lokale për kategoritë e individëve që përcaktohen në ligj.

4. Zbatimi i këtij programi siguron punësimin nëpërmjet:

a) lidhjeve të kontratave me individë për të punuar për zbatimin e projekteve;

b) punësimit të përkohshëm në subjekte, që kryejnë veprimtari në fusha me interes të përgjithshëm publik.

5. Kanë të drejtë të aplikojnë për financim ose bashkëfinancim për projekte për punë publike:

a) organet e pushtetit lokal;

b) organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve;

c) organizatat joqeveritare, të specializuara në këtë drejtim;

d) subjektet ekonomike fitimprurëse, të specializuara në këtë drejtim.

6. Financimi i projekteve aprovet kur:

a) garanton respektimin e kërkesave të ligjit “Për punët publike”, të këtij vendimi dhe i të drejtave të tjera të punëmarrësve, sipas legjislacionit në fuqi;

b) objekti i zbatimit të projektit sjell përfitim publik të drejtpërdrejtë për njësinë administrative lokale;

c) niveli i regjistruar i papunësisë në rreth është më i madh se 8 për qind i fuqisë së aftë për punë, ose numri i përfituesve të ndihmës ekonomike është të paktën 5 për qind e popullsisë së njësisë administrative lokale (bashkisë ose komunës);

d) të paktën 50 për qind e atyre që janë marrë me kontratë janë përfitues nga programet shtetërore të mbështetjes me të ardhura ose të papunë afatgjatë;

e) 60 për qind e financimit të kërkuar nga ky program përdoret për fuqi punëtore;

f) kohëzgjatja e punimeve për zbatimin e projektit është jo më e madhe se 6 muaj;

g) sigurohet të paktën 5 për qind kontribut i jashtëm financiar ose në natyrë;

h) të jetë i hartuar nga persona të autorizuar.

7. Subjektet fitimprurëse, përfitojnë financim për projekte, të cilat do të zbatohen nga ata, vetëm në rastet kur, përveç plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, realizohen dhe:

a) fitimi i subjektit nuk është më i madh se 15 për qind e kostos që shpenzohet për fuqi punëtore;

b) garantohet zbatimi i projekteve me një shumë të paktën sa 10 për qind e kostos së preventivuar të projektit.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë, për mbulimin e kostos për punësim të përkohshëm:

a) njësitë ekonomike në vartësi të pushtetit lokal dhe institucionet shtetërore që kryejnë shërbime publike;

b) subjektet jofitimprurëse.

9. Një aplikim për financimin e punësimit të përkohshëm në subjekte aprovohet kur:

a) garantohet respektimi i kërkesave të ligjit “Për punët publike” të këtij vendimi dhe i të drejtave të tjera të punëmarrësve, sipas legjislacionit në fuqi;

b) punësimi i kërkuar u sjell përfitim të drejtpërdrejtë shërbimeve publike dhe interesave të njësive administrative lokale;

c) kohëzgjatja e angazhimit të punës është jo më e madhe se 6 muaj;

d) kontribuohet në para, ose në natyrë, nga burime të tjera të paktën me 5 për qind të masës së financimit të kërkuar.

10. Për mbulimin e kostos të fuqisë punëtore të punësuar, sipas këtij programi, fondet e Buxhetit të Shtetit financojnë:

a) jo më tepër se 110 për qind të pagës minimale për mbulimin e shpenzimeve për paga;

b) 100 për qind të shpenzimeve për mbulimin e kostos së kontributeve të punëdhënësit për sigurime shoqërore të detyrueshme.

11. Vëllimi i punës që ngarkohen të kryejnë personat e angazhuar me punë nga ky program nuk mund të jetë më i madh sesa ai që i përgjigjet pagës që u jepet për këtë qëllim.

12. Çmimet për vëllim punonjësi përcaktohen sipas një mesatareje, në bazë rrethi, e cila duhet të jetë aprovuar më parë nga Komiteti Shtetëror i Punëve Publike.

13. Aplikimet për financime nga ky program i paraqiten zyrës kompetente të punësimit, e cila bën verifikimin dhe klasifikimin e tyre në përputhje me kriteret.

Zyra kompetente e punësimit është përgjegjëse për kontrollin e ecurisë së zbatimit të projektit ose të punësimit të financuar. Zyra e punësimit punëson me kontratë personel teknik dhe pajis me logjistikën e duhur për kryerjen e funksioneve që u ngarkohen.

14. Për propozimet me kosto të preventivuar nën 2 milionë lekë, vendimi merret nga zyra përkatëse e punësimit. Për propozimet me vlerë deri në 5 milionë lekë, vendimi merret nga komisioni i posaçëm që krijohet pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Për propozimet mbi 5 milionë lekë, vendimi merret nga Komiteti Shtetëror i Punëve Publike. Sasia e fondit të vënë në dispozicion të çdo rrethi nga ky program vendoset nga Komiteti Shtetëror i Punëve Publike, me propozimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

15. Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe organet e pushtetit lokal organizojnë kontrollin dhe inspektimin e veprimtarisë, në zbatim të këtij programi dhe të subjekteve që përfitojnë financime nga ky program.

16. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e procedurave për përdorimin e fondeve për punët publike.

17. Për kriteret e përcaktuara në pikat 6, 7 dhe 9 të këtij vendimi mund të bëhen përjashtime vetëm me vendim të Komisionit Shtetëror të Punëve Publike.

18. Ngarkohet Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

19. Pikat 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.563, datë 9.10.1995 “Për aplikimin e punëve publike”, ndryshuar me vendimin nr.179, datë 18.3.1996 të Këshillit të Ministrave, vendimin nr.857, datë 16.12.1996 të Këshillit të Ministrave dhe vendimin nr.175, datë 6.3.1998 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.409, datë 1.7.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.137,
DATË 31.3.1994 “PËR DISA NDRYSHIME NË ÇMIMET E ARTIKUJVE
ENERGJETIKË”**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.137, datë 31.3.1994 “Për disa ndryshime në çmimet e artikujve energjetikë”, në pikën 2 në shkronjën “a” shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me cilësinë përfaqësuesit të pronës shtetërore, ka të drejtë të vendosë që pagesat e prapambetura të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë të bëhen pa kamatvonesa”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.410, datë 1.7.1998

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.710,
DATË 18.12.1995 “PËR ZBATIMIN E ÇMIMEVE TË ULËTA TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, GAZOILIT, QYMYRGURIT DHE UJIT, PËR PRODHIMIN E
BUKËS”**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.710, datë 18.12.1995 “Për zbatimin e çmimeve të ulëta të energjisë elektrike, gazoilit, qymyrgurit dhe ujit, për prodhimin e bukës” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr.411, datë 1.7.1998

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË FORMIMIT PROFESIONAL TË PERSONELIT TË BURGJEVE

Në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 “Për policinë e burgjeve”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e “Qendrës së formimit profesional të personelit të burgjeve”, për kualifikimin e punonjësve të personelit dhe të efektivit të policisë së burgjeve.

2. Numri i punonjësve të shkollës të caktohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Ky numër të jetë brenda numrit të përgjithshëm organik, të miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

3. Shpenzimet për krijimin dhe funksionimin e kësaj shkolle mbulohen nga fondet e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë të miratuara për vitin 1998.

4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e akteve dhe të rregullave për funksionimin e kësaj shkolle.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**V E N D I M
Nr.416, datë 9.7.1998**

**PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË MINISTRISË
SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT NGA PRIVATIZIMI I
SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORË JOSTRATEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorë jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe të shoqërive tregtare shtetërore nga të ardhurat, prej 20 për qind, të përfituara nga shitja e paketës së aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë.

2. Ky fond administrohet dhe përdoret nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për:

a) zhvillimin e ndërmarrjeve që nuk janë transformuar në shoqëri tregtare shtetërore;
b) asistencë teknike për mbështetje pas transformimit në shoqëri tregtare shtetërore, për të ndihmuar në privatizimin e paketës së aksioneve të tyre;

c) promovimin e procesit të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare shtetërore;

ç) përgatitjen e dokumenteve për termat e referencave të tenderave, si formë e privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërive tregtare shtetërore.

3. Kontrolli i administrimit dhe i përdorimit të këtij fondi bëhet në përputhje me rregullat që zbatohen për fondet buxhetore, sipas ligjit nr.7617, datë 30.9.1992 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë udhëzimin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.417, datë 9.7.1998

PËR ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE NGA SHITJA E AKTIVEVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA NË SHOQËRITË ANONIME, ME KAPITAL THEMELTAR TËRËSISHT SHTETËROR

Në zbatim të nenit 129 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të nenit 10 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, si dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për shoqëritë anonime, me kapital themeltar tërësisht shtetëror, të realizohet me ankand në lekë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, me miratimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Procedura e shitjes të realizohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”.

3. Të ardhurat nga shitja të derdhen 5 për qind për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe 95 për qind për llogari të shoqërisë anonime.

4. Regjistrimet për shitjet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, si veprim me efekt në rezultatin e ndërmarrjes, të bëhen sipas ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.418, datë 9.7.1998

PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË FALIMENTUARA NË RRUGË ADMINISTRATIVE

Në zbatim të dekretit të Presidentit të Republikës nr.1561, datë 25.7.1996 “Për një shtesë në ligjin nr.8017, datë 25.7.1995 “Për procedurat e falimentimit”” miratuar me ligjin nr.8140, datë 5.9.1996, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e falimentimit dhe të likuidimit në rrugë administrative të këtyre ndërmarrjeve:

Uzina 12 në Kombinatin Metalurgjik Elbasan, Uzina e sodë-PVC-së në Vlorë, Fabrika e letrës Kavajë.

2. Likuidimi i ndërmarrjeve të shpallura të falimentuara kryhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Caktimi i likuidatorit ose likuidatorëve, miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Shitja e ndërmarrjeve në likuidim bëhet sipas procedurave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet dhe procedurat e shitjes”, me miratimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Mjetet e xhiros mund të shiten në treg të lirë, me çmimet korente.

5. Me miratimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, mbi bazën e raportit të ekspertëve vlerësues, mund të nxirren jashtë përdorimit linja e reparte të ndërmarrjeve të shpallura të falimentuara në rrugë administrative.

6. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit miraton dhe nxjerr udhëzime të posaçme për fillimin dhe zbatimin e procedurave të demolimit, për linjat e repartet e nxjerra jashtë përdorimit, sipas pikës 5 të këtij vendimi.

Shpenzimet e demolimit përballohen me fondet që sigurohen nga shitja e mbetjeve të dala prej tij.

7. Për objektet e ndërmarrjeve të falimentuara, që janë në procesin e likuidimit dhe që deri në datën e daljes së këtij vendimi janë zënë nga familjarë, të zbatohen procedurat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.197, datë 20.3.1998 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve që nuk kanë qenë e mundur të shiten”.

8. Arkëtimet në lekë të vlerave të shitjes së pasurisë dhe të detyrimeve debitore të ndërmarrjes në likuidim derdhen në llogarinë e hapur prej saj, pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

Bankave, organeve të tatimeve, si dhe organeve të tjera shtetërore u ndalohet të vënë dorë në llogarinë e veçantë të ndërmarrjes në likuidim.

Mjetet monetare të kësaj llogarie disponohen vetëm me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Përdorimi i të ardhurave në lekë bëhet me miratimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, sipas kësaj radhe:

a) për të përballuar pagat dhe shtesat mbi pagë për punonjësit e ndërmarrjes në likuidim;

b) për shlyerjen e detyrimeve, deri në kufirin që lejojnë shumat e arkëtuara në lekë.

Shlyerja e detyrimeve ndaj kreditorëve mund të bëhet edhe pjesë-pjesë, pa prituri likuidimin e plotë të ndërmarrjes. Radha e shlyerjes së kreditorëve miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

c) për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera, që lidhen me administrimin, ruajtjen dhe likuidimin e ndërmarrjes.

9. Teprica që mund të rezultojë, pasi të zbriten nga totali i të ardhurave në lekë përdorimet sipas pikës 8 të këtij vendimi, me miratimin e Ministrisë së Financave, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

10. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse për të.

11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.620, datë 16.9.1996 “Për shpalljen e falimentimit dhe kalimin në likuidim të disa ndërmarrjeve në varësi të Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.426, datë 9.7.1998

**PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË
VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BRENDA
DHE JASHTË SHTETIT**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për çdo rast fatkeqësie (vdekje), Buxheti i Shtetit jep një ndihmë për shtetasit, sipas vendbanimeve dhe grupmohave, në masën e përcaktuar në bazë rrethesh, të grupuara në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit përballon ndihmën në rast fatkeqësie, sipas pikës 1, vetëm për shtetasit, vendbanimet e të cilëve janë në zona urbane.

Për shtetasit, vendbanimet e të cilëve janë në zona rurale, këshillat e rretheve dhe komunat, brenda fondeve të tyre, të japin në rast fatkeqësie (vdekje) një ndihmë sipas pikës 1, e cila përballohet nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet këshillave të rretheve dhe komunave përkatëse.

3. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit organizon shërbimin e transportimit të kufomave dhe të eshtrave për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë shtetit, të cilët kanë qenë me banim në Shqipëri dhe janë larguar pas datës 1.1.1990. Shpenzimet e këtij shërbimi mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Për rastet kur shpenzimet e transportimit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursos një pjesë të këtyre shpenzimeve, sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës.

4. Këshillat e rretheve organizojnë heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve, me ose pa vendim gjyqi, të të burgosurve politikë, që kanë vdekur në burg ose në vendet e dënimit, pa u dënuar, si dhe të të vvarëve në kufi, në orvajtje për t'u arratisur.

Shpenzimet përballohen nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet buxhetit të këshillave të rretheve përkatëse.

5. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ngarkohet të nxjerrë udhëzimin përkatës për mënyrën e organizimit të këtij shërbimi dhe të financimit e të likuidimit të tij.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.372, datë 28.8.1992, nr.484, datë 10.11.1992, nr.189, datë 16.4.1993 dhe nr.8, datë 17.11.1994, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista e rretheve të grupuara sipas masës së ndihmës në rast fatkeqësie:

Nr.	Rrethi	Zonat urbane i Zonat Rurale			
		0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç	0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç
I	Tiranë	5800	9600	2200	3600
II	Shkodër	5000	8400	2200	3600
	Durrës	5000	8400	2200	3600
	Elbasan	5000	8400	2200	3600
	Vlorë	5000	8400	2200	3600
	Korçë	5000	8400	2200	3600
	Fier	5000	8400	2200	3600
	Berat	5000	8400	2200	3600
	Gjirokastër	5000	8400	2200	3600
	Kavajë	5000	8400	2200	3600
	Krujë	5000	8400	2200	3600
	Lezhë	5000	8400	2200	3600
	Lushnjë	5000	8400	2200	3600
	Pogradec	5000	8400	2200	3600
	Sarandë	5000	8400	2200	3600
	Dibër	4300	7200	2200	3600
	Gramsh	4300	7200	2200	3600
	Kolonjë	4300	7200	2200	3600
	Kukës	4300	7200	2200	3600
	Kurbin	4300	7200	2200	3600
	Librazhd	4300	7200	2200	3600
	Mirditë	4300	7200	2200	3600
	Mat	4300	7200	2200	3600
	Përmet	4300	7200	2200	3600
	Pukë	4300	7200	2200	3600
	Skrapar	4300	7200	2200	3600
	Tepelenë	4300	7200	2200	3600
	Tropojë	4300	7200	2200	3600
	Bulqizë	4300	7200	2200	3600
	Delvinë	4300	7200	2200	3600
	Devoll	4300	7200	2200	3600
	Has	4300	7200	2200	3600
	Kuçovë	4300	7200	2200	3600
	Mallakastër	4300	7200	2200	3600
	Peqin	4300	7200	2200	3600
	Malësi e Madhe	4300	7200	2200	3600

V E N D I M
Nr.430, datë 9.7.1998

**PËR DHËNIEN ME QIRA TË OBJEKTEVE TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE
OSE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE**

Në zbatim të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanskionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit””, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objektet e ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore, ku përfshihen ndërtesa, truallit dhe makineritë e pajisjet, mund t’u jepen me qira të tretëve në kushtet e mëposhtme:

a) Objektet me sipërfaqe deri 200 m² jepen me qira për një afat jo më shumë se një vit kalendarik. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë e ka vetë ndërmarrja, shoqëria a institucioni.

b) Objektet me sipërfaqe 200-500 m², si dhe grup ndërtimesh kapacitive (rezervuarë dhe depozita karburanti, sillose etj.) jepen me qira për një afat jo më shumë se 5 vite kalendarike. Të drejtën e lidhjes së kontratës e ka ministria ose organi i pushtetit lokal, në administrimin e të cilit është ndërmarrja, shoqëria a insitucioni shtetëror.

c) Objektet me sipërfaqe mbi 501 m², si dhe grup ndërtimesh kapacitive (rezervuarë dhe depozita karburanti, sillose etj.) jepen me qira për një afat jo më shumë se 20 vite kalendarike. Të drejtën e lidhjes së kontratës e ka Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Në rastet e parashikuara në gërmën “a” dhe “b” dhënia me qira bëhet vetëm për objekte të veçanta të ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore, pa cenuar objektin kryesor të veprimtarisë ose tërësinë e objekteve të tyre.

2. Në rastin kur jepen me qira ose enfiteozë tërësia e objekteve të ndërmarrjes, shoqërisë ose institucionit shtetëror, pavarësisht nga madhësia e sipërfaqes, lidhja e kontratës përkatëse bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në përputhje me dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.195, datë 20.3.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”.

3. Çmimi i qirasë për ndërtesat dhe ndërtimet kapacitive caktohet sipas kritereve të mëposhtme:

a) Në rrugët kryesore dhe në segmente rrugësh me trafik të dendur në qytetet Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Progradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Delvinë, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Laç e Lezhë, si dhe brenda vijave kufizuese të këtyre qyteteve ose në qendrat e banuara turistike, çmimi i qirasë për ndërtesat është 1 USD/m² në muaj.

Për ndërtimet kapacitive, çmimi i qirasë është 3 USD/m³ në muaj.

Përgjashtimisht, për institucionet, ndërmarrjet ose shoqëritë shtetërore, me karakter kombëtar të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve, çmimi dysHEME i qirasë është 3 USD/m² në muaj. Institucionet, ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore të karakterit kombëtar, përcaktohen nga Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

b) Në territorin e rretheve jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme, çmimi i qirasë për ndërtesat është 0,5 USD/m² në muaj;

Për ndërtimet kapacitive, çmimi i qirasë është 2 USD/m³ në muaj.

c) Në rrethet e Devollit, Kolonjës, Mallakastrës, Peqinit, Tepelenës, Peshkopisë, Kukësit, Përmetit, Bulqizës, Gramshit, Hasit, Kuçovës, Librazhdit, Malësisë së Madhe, Matit, Mirditës, Skraparit dhe Tropojës çmimi i qirasë për ndërtesat është 0,3 USD/m² në muaj.

“Për ndërtimet kapacitive, çmimi i qerasë është 2 USD/m³ në muaj”.

“Çmimi i qirasë së truallit të lirë (jo nën ndërtesë) përcaktohet sipas pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.6.1994.

4. Për makineritë, pajisjet dhe galeritë qiraja llogaritet sipas VAM-it të llogaritur në kapitullin e parë, pika 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes” dhe kjo vlerë të shumëzohet me 5.

5. Për objektet me sipërfaqe mbi 500 m², vlera e qirasë e llogaritur sipas pikës 3 dhe 4 të këtij vendimi, llogaritet me zbritje kur subjekti qiramarrës plotëson kriteret si më poshtë:

a. Kriteri i punësimit (mesatare vjetore)

- kur punësohen 10-20 punëtorë 0,9 e çmimit;
- kur punësohen 21-50 punëtorë 0,8 e çmimit;
- kur punësohen 51-150 punëtorë 0,7 e çmimit;
- kur punësohen 151-300 punëtorë 0,6 e çmimit;
- kur punësohen 301-500 punëtorë 0,5 e çmimit;
- kur punësohen mbi 501 punëtorë 0,4 e çmimit.

b. Investimet (vjetore)

- 300-500 mijë USD 0,9 të çmimit të fiksuar;
- 501 mijë - 1 milion USD 0,8 të çmimit të fiksuar;
- dhe mbi 1 milion USD 0,7 të çmimit të fiksuar.

Pagesa e bërë sipas kriterëve të mësipërme të jetë 3-mujore.

6. Llogaritja e qirasë, e përcaktuar në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, është e vlefshme edhe për kontratën e enfitozës, e cila do të lidhet për një afat kohor jo më pak se 10 vjet.

Kjo kontratë do të përdoret dhe për shoqëritë tregtare.

7. Të ardhurat nga dhënia me qira ndahen si vijon:

a) për objektet sipas gërmës “a”, të pikës 1:

50 % për ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror

50 % për Buxhetin e Shtetit.

b) Për objektet sipas pikës “b” të pikës 1:

50 % për ndërmarrjen, shoqërinë ose institucionin shtetëror;

10 % për ministrinë e linjës ose pushtetin lokal, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes, shoqërisë ose institucionit shtetëror;

40 % për Buxhetin e Shtetit.

c) Për objektet sipas pikës “c” të pikës 1:

20 % për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

80 % për Buxhetin e Shtetit kur objektet e ndërmarrjes, shoqërisë ose institucionit shtetëror jepen me qira në tërësinë e tyre.

7.1 Ndarja e të ardhurave nga dhënia me qira apo enfitozë për institucionet, ndërmarrjet ose shoqëritë shtetërore të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve të bëhet:

a) për objektet e dhëna me qira sipas pikës 1, shkronja “a”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998:

90 % për institucionin, ndërmarrjen ose shoqërinë shtetërore;

10 % për qind për Buxhetin e Shtetit;

b) për objektet e dhëna me qira sipas pikës 1, shkronja “b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998:

60 % për institucionin, ndërmarrjen a shoqërinë shtetërore;

25 % për Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve;

15 % për Buxhetin e Shtetit;

c) për objektet e dhëna me qira sipas pikës 1, shkronja “c”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998:

50 % për institucionin, ndërmarrjen a shoqërinë shtetërore;

30 % për Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve;

20 % për Buxhetin e Shtetit.

Kur pasuritë e institucionit, ndërmarrjes a shoqërisë shtetërore jepen tërësisht me qira apo enfiterozë:

10 % për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

40 % qind për Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve;

50 % për Buxhetin e Shtetit.

Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha objektet që jepen me qira pavarësisht nga varësia e tyre, lokale ose kombëtare.

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.589, datë 16.10.1995, nr.155, datë 4.3.1996 dhe 217, datë 24.5.1997, shfuqizohen.

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.440, datë 16.7.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.591,
DATË 24.12.1997 “PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE TË MBETURA NË FLOTËN
DETARE TREGTARE, NË DURRËS”**

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.591, datë 24.12.1997 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“Ngarkohet AKP-ja të lidhë, në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, “kontratën e shitjes me rezervë të pronës” për anijen “Tirana”, në favor të personave fitues, të ankandit, sipas përcaktimit të autorizimit për kalim pronësie, nr.255, datë 24.1.1996 të lëshuar nga kjo agjenci.

“Kontrata e shitjes me rezervë të pronës” për anijen “Tirana” të datohet me datën e lëshimit të autorizimit.

Diferenca e pagesës për këtë anije, sipas kushteve të autorizimit nr.255, datë 24.1.1996, të bëhet brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi, pas mbërritjes së saj në Durrës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.442, datë 16.7.1998

PËR KRIJIMIN E SH.A.- së “AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e “Agjencisë për zhvillimin ekonomik” (AZHE) si shoqëri anonime, me kapital shtetëror, me seli në Tiranë. Veprimtaria e kësaj shoqërie rregullohet sipas statutit që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Objekti i shoqërisë është promovimi i zhvillimit ekonomik të vendit, nëpërmjet:

- a) përgatitjes, publikimit dhe shpërndarjes së informacionit ekonomik e promovues;
- b) nxitjes së investimeve të huaja e të vendit;
- c) nxitjes së tregtisë dhe të eksporteve;
- d) promovimit të programit të privatizimit të sektorëve të ekonomisë;
- e) propozimit të akteve të nevojshme ligjore e procedurale.

3. Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë përbëhet nga gjashtë anëtarë. Në përbërje të kësaj mbikëqyrës të jenë persona që gëzojnë autoritet në fushën e ekonomisë, të financës, të sistemit bankar, të biznesit dhe të informacionit.

Emërimi i organeve drejtuese dhe funksionimi i tyre përcaktohen në statutin e shoqërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për hartimin e akteve të nevojshme për themelimin e shoqërisë dhe regjistrimin e saj në gjykatë.

5. Mjetet kryesore, objektet, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe buxheti i miratuar për vitin 1998, për qendrën shqiptare të nxitjes së investimeve të huaja, i kalojnë sh.a.- së “Agjencia për zhvillimin ekonomik” (AZHE).

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 9.1.1993 “Për krijimin e qendrës shqiptare të nxitjes së investimeve të huaja” shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor,2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarrimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 9. 4. 2003
Doli nga shtypi më 11.4. 2003

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 200 lekë